

FJALA E DEPUTETES GERTA DURAKU

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

E sotmja është një ditë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe ekonominë e çdo shqiptari. Buxheti që ne kemi sot përpara është vazhdimi i një vizioni të qartë për ta bërë Shqipërinë kampione të Ballkanit në çdo sektor. Ky buxhet, përveç faktit që i jep frymëmarrje ekonomisë së vendit, është po ashtu buxheti i rritjes së pagave dhe uljes së taksave për kategoritë që kërkojnë mbështetje nga shteti. Vazhdimi i rritjes së pagave për mjekët dhe infermierët, mësuesit, Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura do të jenë fakt i së nesërme. Nga ana tjetër, vërehet qartë se ne mbetemi një qeveri sociale. Siç është bërë më dije, në këtë buxhet, ne trefishojmë ndihmën ekonomike për gratë e trafikuarat dhe të dhunuara dhe fëmijët jetimë nën 18 vjeç. Dyfishojmë ndihmën ekonomike për rreth 15 mijë familje, që kanë tre apo më shumë fëmijë deri në 18 vjeç. Po ashtu, ne do të rrisim me 10% ndihmën ekonomike për pjesën tjetër të familjeve, që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike. Ky buxhet rrit mbështetjen me 26 milionë dollarë për indeksimin e pensioneve dhe 36 milionë dollarë për bonusin e fundvitit. Nuk përfiton vetëm kjo fashë, pasi edhe për foshnjat e porsalindura financimi do të jetë 23 milionë dollarë. Në këtë buxhet të gjithë sektorët marrin më shumë vëmendje.

Dua të ndalem te sektori i bujqësisë. Sa u përket fermerëve, ka një rritje me 42% më shumë së në vitin 2021. Kjo rritje do të përkthehet në më shumë prodhim dhe punësim. E them këtë, sepse Kukësi, Tropoja dhe Hasi kanë shumë nevojë për këtë mbështetje dhe për këtë arsye unë jam pro këtij buxheti, pasi bujqësia është sektori që e ndjen më shumë së kushdo tjetër kujdesin e shtetit. Turizmi është një tjetër pikë e fortë mbështetëse për ekonominë kombëtare dhe lokale. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka turizmi në të ardhurat kombëtare, dua të theksoj se ky sektor ngelet po ashtu prioritar dhe do të jetë në vëmendjen e qeverisë për vitin 2022. Një punë e mirë është bërë edhe me rregullimin e qendrave të qyteteve dhe infrastrukturën rrugore. Ky buxhet e çon një hap më para këtë ambicie për një Shqipëri me infrastrukturë moderne dhe një territor me porta të mëdha hyrëse për turistët. Vitin që vjen këto investime do të mundësojnë të vazhdojmë me ndërtimin e një qendre turistike në Valbonë-Tropojë, Pashtrik-Krumë dhe një qendër turistike buzë liqenit në Kukës. Pa harruar pastërtinë, e cila nuk është thjesht një aksion, por një ambicie për një jetë më të shëndetshme dhe një Shqipëri të pastër në sytë e çdo turisti. Vendi ynë ka përballuar 2 kriza, që vijnë një herë në 100 vjet, siç janë tërmeti dhe pandemia. Të prekurit nga tërmeti kanë hyrë dhe vijojnë të hyjnë në shtëpitë e reja. Po ashtu, sa i përket pandemisë, në vijojmë financimin e vaksinimit me 27 milionë dollarë. Ja pra, kjo është mbajtja e fjalës së dhënë dhe qëndrimi krah çdo qytetari.

Të nderuar kolegë,

Çdo sektor merr vëmendjen e posaçme nga ky buxhet, ndoshta jo sa do të donim, por maksimalisht sa është mundësia, por një gjë është e sigurt: këto nuk janë investime rastësore, por një vizion i qartë, që sjell lehtësi për biznesin, mbështetje për të pamundurin, mundësi për ata që kanë vullnet dhe, pa diskutim, largpamësi për të ardhmen afatshkurtër dhe afatgjatë. Ndaj, ju ftoj të votoni për një Shqipëri që ecën më kokën lart! Faleminderit!